



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr.40 dt. 22.07.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 22.07.2014 pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Propozimin për "Përcaktimin e zonës së mbrojtur të objektit "Universiteti i Tiranës" në sheshin "Nënë Tereza", monument kulture të kategorisë së II (dytë)", sipas hartës bashkëlidhur.
2. Kufiri i zonës së mbrojtur përshkruhet si më poshtë:
  - veri - në aks të rrugës "Lekë Dukagjini" me gjatësi 190m
  - lindje - paralel me kufirin e rrugicës së hyrjes së hotel "Sheraton" me gjatësi 76m
  - jug - paralel me aksin e rrugës "Lekë Dukagjini", 76m në jug të kësaj rruge dhe me gjatësi 195m
  - perëndim - 195 m nga kufiri lindor (nga rrugica e hotel "Sheraton").
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për regjistrimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

